



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.761/ 14 Prot.,

Datë 08.04.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 479 /2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.04.2026 shqyrtoi ankesën me

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ADD GROUP” ShPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” Mallra, me Nr. REF-74979-02-02-2026, me objekt “Blerje Tonerash për Vitin 2026”. me fond limit 1,666,380 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Ervin Luzi” P.F. në procedurën e prokurimit sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “ADD GROUP” ShPK në procedurën e prokurimit sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Ervin Luzi” P.F. në procedurën e prokurimit sipërcituar.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “ADD GROUP” ShPK me NIPT L81722022V, Adresa: Rr. "Bulevardi Nënë Tereza", Nr pasurie 9/22, Kamëz.

Operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK, me Nipt J62426002Q, Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 8, Kashar, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Vlorë.  
Adresa: Sheshi 4 Heronjtë, Vlorë.

**Subjekt i Interesuar:** Operatori ekonomik “Ervin Luzi” P.F, me Nipt L81722022V, Adresa: Rr. Ali Pashë Gucia, Godina nr.5 , L. Katund i Ri Kashar, Tiranë.

Operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK, me Nipt J62426002Q Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Kodër Kashar, Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetura në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesa në SEA, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.5. Operatorët ekonomikë ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave në Sistem.

## II

### Rrethanat e çështjes

II.1. Në datë 03.02.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, Mallra, me Nr. REF-74979-02-02-2026, me objekt “Blerje Tonerash për Vitin 2026” me fond limit 1,666,380 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

II.2 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), rezulton se autoriteti kontraktor në datën 23.02.2026 ka përfunduar vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në SPE dhe ka kryer renditjen e tyre si vijon:

Operatorët ekonomikë	Vlerat e ofertave	Vlerësimi
<b>1- ADD Group ShPK</b>	766,800	SKualifikuar
<b>2- InfoSoft Office ShPK</b>	797.000	Kualifikuar
3- LIBRARI DYRRAHU ShPK	833.190	Kualifikuar
4- IT Gjergji Kompjuter ShPK	890.000	Kualifikuar
<b>5- BOA SORTE ShPK</b>	944,800	SKualifikuar
6- MARKETING & DISTRIBUTION ShPK	1.100.134	Kualifikuar
7- ERVIN LUZI P.F	1.150.000	Kualifikuar

II.3. Nga verifikimet e kryera në SPE Autoriteti Kontraktor më datë **06.03.2026**, ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak për procedurën e prokurimit.

II.4 Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6403, datë **10.03.2026** dhe me Nr. 761/2026 Prot., date 10.03.2026, si edhe ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6404, datë 10.03.2026 dhe me Nr. 761/1/2026 Prot., datë 10.03.2026 nga operatori ekonomik “**ADD GROUP**” ShPK, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ADD GROUP” ShPK si edhe kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Ervin Luzi” P.F në procedurën e prokurimit sipërcituar.

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 4 germa “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e

prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe Formularin për Publikim me nr. 761/2 prot., datë 11.03.2026, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë si vijon:

*“Mbi të drejtën e ankimit, do të paraqesim argumenta së përse kërkojmë skualifikimin e ofertës ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik Ervin Luzi PF si dhe kundërshtojmë vlerësimin e datë 23.02.2026 nga KVO, ku jemi refuzuar si oferte anomalisht e ulët.*

*Kundërshtojmë klasifikimin e ofertes tonë si “anomalisht të ulët”, për shkak se ky konstatim nga KVO vjen si shkak pasojë i një vlerësimi të pasakatë dhe të padrejtë të ofertave ekonomike të operatoreve të tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi publik. Interesi jonë është I lartë për këtë procedurë e si për rrejedhojë nese autoriteti kontraktor do të kishte kryer një vlerësim të saktë edhe në përputhje me dokumentat e tenderit dhe legjislacionit në fuqi ofertën e operatorit ekonomik Ervin Luzi Person fizik, atëherë kjo ofertë do të ishte skualifikuar për mosplotësim të kriterëve dhe per parregullesi të konstatuara që dyshojmë tek “formulari i vetdeklarimit” dhe tek formulari i ofertës ekonomike që nuk është e plotësuar siç është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.*

*Ndaj duke qënë se kemi interesë të lartë dhe cmojmë që jemi dëmtuar nga vlerësimi I KVO, duke kualifikuar një ofertë ekonomike që nuk ndërtuar sipas ligjit edhe sipas cdo ndryshimi ligjore të pasuar në vijim, dhe kështu duke na privuar ofertën tonë si anomalisht të ulët.*

*1 - OE Ervin Luzi P.F nuk ka plotësuar siç është kërkuar në dokumentat standarte të tenderit duke parashikuar edhe afatin e lërvimit: sipas Shtojca 3.*

*2 – OE Ervin Luzi është PF, edhe bazuar në ligjin nr. 112/2020 “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues”, dyshojmë që opertori ekonomik nuk ka bërë plotësimin sic ligji parashikon të kesajë deklaratë: (bashkangjitur shtojcën 9) është plotësuar mbi të dhëna të paskta, ju theksojmë që nuk është një gabim formal që mund të sqarohet apo ndryshohet.*

*Ligji nr 112/2020 “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues”, nenin 2/1 “Fusha e zbatimit”, ka parashikuar që ky ligj nuk zbatohet për:*

- a) Personat fizike, tregtare te regjistruar në regjistrin tregtar;*
- b) Personat juridikë dhe ndërmarrjet, aksionari I vetëm I të cilëve janë institucionet qendrore dhe/ose vendore të Republikës së Shqipërisë;*
- c) Bashkesitë fetare;*
- d) Partitë politike.*

*Pra shprehimisht ky ligj nuk është i zbatueshëm për personat fizik si në rastin tonë kemi OE Ervin Luzi PF, të kualifikuar si ofertë e vlefshme për procedurën objekt ankesë.*

***Në këtë deklaratë pretendojmë që Ervin Luzi Pf, ka bërë deklaratë të pasaktë që bie në kundërshtim me statusin e tij, dhe kjo mund të intepretohet deklarim i rremë ose i paskkate në ekementet thelbësore të ofertës. Për rrjedhojë, deklarata e operatorit ekonomik është e pasaktë dhe nuk pasqyron situatën reale ligjore të subjektit. Formulari i vetëdeklarimit kërkon deklarime të sakta dhe të vërteta nga operatorët ekonomikë pjesë marrës në procedura të prokurimit publik. Deklarimi i një fakti që nuk ekziston përbën paraqitje të pasaktë të informacionit në dokumentacionin e procedurës së prokurimit dhe duhet të konsiderohet si mosplotësim korrekt i formularit të vetëdeklarimit, duke sjellë skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik në fjalë. Shtojca 9 është një deklaratë vullneti nën përgjegjësi ligjore. Çdo pasaktësi në këtë formular e bën atë të pavlefshëm.***

*Sipas praktikës konstante të KPP-së, elementet e Shtojcës 9 nuk mund të sqarohen apo korrigjohen pas hapjes së ofertave, pasi kjo do të përbënte një ndryshim të ofertës.*

II.6. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ, në përputhje me nenin 113 të LPP-së, rezulton, se në sistemin e ankesave elektronike është dorëzuar Formulari i argumenteve, protokolluar me nr.761/3, date 13.03.2026, si edhe i njeiti Formular Argumente, aplikuar në sistem, protokolluar me tonën me nr.761/4, date 17.03.2026 nga operatori ekonomik të interesuar “InfoSoft Office” ShPK i cili kundërshton ankesën e operatorit ekonomik ADD Group ShPK me argumente në mënyrë të përmbledhur:

*[...]1. Të mbetet i skualifikuar ankimuesi për ofertë anomalisht të ulët, pasi nuk ka të drejtë përsa kohë është i skualifikuar, bazuar në ndryshimet në legjislacionin e PP mbi skualifikimin e ofertave anomalisht të ulëta pa kërkuar sqarime në PP nën kufirin e lartë monetar.*

*2. Të mos pranohen pretendimet mbi skualifikimin e OE Ervin Luzi P.F. [...]*

II.7. Me shkresën, ardhur në sistem me Nr. 5040/1 Prot., datë. 13.03.2026, protokolluar me tonën me Nr. 761/5, datë 17.03.2026, si edhe shkresa ardhur me shërbim postar me Nr. 5040/1 Prot., datë. 13.03.2026, protokolluar me tonën me Nr. 761/6, datë 17.03.2026, Autoriteti kontraktor ka përcjellë për Komisionin dhe për dijeni ADD Group ShPK, Vendimin e KSHA-së lidhur me Ankesën me Nr. Prot. 761/2026 datë 10.03.2026.

Referuar Vendimit të KSHA-së konstatohet se AK ka pranuar pjesërisht pretendimet e Ankimuesit mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik Ervin Luzi P.F.

II.8. Me shkresën nr. 761/7 datë 19.03.2026 drejtuar Autoritetit kontraktor, Komisioni kërkoi informacion si vijon:

*Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar Formulari paraqitjes së argumenteve nga operatori ekonomik i interesuar “InfoSoft Office” ShPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-74979-02-02-2026, me objekt “Blerje Tonerash për Vitin 2026”, me fond limit 1,666,380 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.*

*Referuar dokumentit, operatori i interesuar “InfoSoft Office” ShPK kundërshton ankesën A/2026/6403, datë 10.03.2026 dhe me Nr. 761/2026 Prot., date 10.03.2026, si edhe ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6404, datë 10.03.2026 dhe me Nr. 761/1/2026 Prot., datë 10.03.2026 nga operatori ekonomik “ADD GROUP” ShPK, për procedurën e prokurimit në lidhje me pretendimet e ankimuesit, në referim të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.*

*Referuar informacionit të autoritetit kontraktor ka përcjellë Vendimin e KSHA-së pranë KPP-së në sistem shkresa me Nr. 5040/1 Prot., datë. 13.03.2026, protokolluar me tonën me Nr. 761/5, datë 17.03.2026, si edhe shkresa ardhur me shërbim postar me Nr. 5040/1 Prot., datë. 13.03.2026, protokolluar me tonën me Nr. 761/6, datë 17.03.2026.*

*Referuar shkresës, Autoriteti kontraktor ka përcjellë shkresën mbi Vendimin e KSHA-së lidhur me Ankesën me Nr Prot. 761/2026 datë 10.03.2026, për Komisionin dhe për dijeni ADD Group ShPK.*

*Në bazuar të neni 113 dhe 114 pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni kërkon të informoni dhe vërtetonin për sa vijon:*

1. A keni njoftuar operatorin ekonomik “InfoSoft Office” ShPK mbi vendimmarrjen e autoritetit tuaj kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës sipërcituar.
2. Nëse po, ju lutem të na dërgoni kopje të librit të protokollit që vërteton dërgimin dhe marrjes e vendimit nga operatori i interesuar.

Me qëllim vijimin e shqyrtimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, duhet të dërgoni pranë Komisionit Informacionin e kërkuar .

II. 9 Me shkresën ardhur me nr.5040/4 prot, datë 24.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 761/8, datë 24.03.2026 autoriteti kontraktor informon se ka përcjellë vendimin e KSHA-së për operatorin ekonomik të interesuar “InfoSoft Office” ShPK, vërtetuar me fotokopje të Regjistrit të dorëzimit në Postë me datë 18.03.2026

II.10. Me shkresën me nr. 761/9 Prot., datë 27.03.2026, drejtuar operatorit ekonomik të interesuar “InfoSoft Office” ShPK “ Komisioni kërkon:

[...] të informohet nga ju, në cilësinë e subjektit të interesuar në kuptim të nenit 113 të LPP-së, mbi datën në të cilën keni marrë dijeni mbi vendimmarrjen e autoritetit kontraktor për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ADD GROUP ShPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, të shoqëruar me dokumentacion provues.

Me qëllim vijimin e shqyrtimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, duhet të dërgoni pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar ..[...]

II.11. Me shkresën ardhur me nr.5040/4 prot, datë 24.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 761/10, datë 30.03.2026 autoriteti kontraktor informon se ka përcjellë vendimin e KSHA-së për operatorin ekonomik të interesuar “InfoSoft Office” ShPK, vërtetuar me fotokopje të Regjistrit të dorëzimit në Postë me datë 18.03.2026 .

II.12 Me shkresën ardhur protokolluar me tonën me Nr. 761/11, datë 31.03.2026, operatori ekonomik i interesuar **“InfoSoft Office” ShPK informon:** [...] Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se shkresa me Nr. 5040/2, datë 18.03.2026 ka mbërritur pranë zyrave tona me anë të Posta Shqiptare me datë **26.03.2026**. Bashkëlidhur kopje e librit të postës për marrje në dorëzim nga “InfoSoft Office” ShPK, të dokumentit.[...]

II.13. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6467, datë 31.03.2026 dhe me Nr. 974/2026 Prot., date 31.03.2026 e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Mallra, me Nr. REF-74979-02-02-2026, me objekt “Blerje Tonerash për Vitin 2026”. me fond limit 1,666,380 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nr.5040/2 Prot., datë 18.03.2025.

II.14. Bazuar në nenin 112 pika 4 germa “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e

prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin e publikimit nr. 974/1 prot., datë 01.04.2026, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë.

**Së Pari:** *KSHA e B. Vlorë, në lidhje me ankesën A/2026/6403, datë 10.03.2026 dhe me Nr. 761/2026 Prot., date 10.03.2026 të ADD GROUP SHPK, ka marrë vendimin e saj më numër 5040/2 prot., me datë 18.03.2026, por "Infosoft Office" SHPK, në datë 26.03.2026, nëpërmjet shërbimit postar, mori dijëni në lidhje me këtë vendim të KSHA-së. Bashkëlidhur kësaj ankese do të gjëni, të skanuar faqen nga libri i dergesave postare, ku vërtetohet dita e marrjes dijëni e Vendimit nr 5040/2 prot. Dt. 18.03.2026 të KSHA-së.*

*Referuar formularit të njoftimit të fituesit paraparak rezulton se, ankuesi ADD GROUP ShPK është skualifikuar nga KVO-ja, me Arsyet e skualifikimit: Nga përlllogaritja, për ofertën anomalisht të ulët duke u bazuar në nenin 93 të LPP dhe neni 82 të VKM. 285, date 19.05.2021, rezulton se oferta e paraqitur nga operatori ekonomik ADD Group është anomalisht e ulët.*

*Pra, ankuesi ADD GROUP SHPK në këtë procedurë prokurimi ka statusin I skualifikuar.*

*Në Kreun II KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 291 datë 15.05.2024 PËR PËRCAKTIMIN E KUFIJVE MONETARË NË PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK, parashikohet se: Pr. Prokurimit është nën kufirin e lartë monetar. Në rastin konkret, në zbatim të pikës 5 të nenit 93 të LPP-së se: në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët, procedura e prokurimit objekt i këtyre argumentave kundërshtuese rezulton nën kufirin e lartë monetar. Nga përlllogaritja e formulës, ku sipas Rr.P.P përfshihen vetëm ofertat e ofertuesve të kualifikuar rezulton se, vlera prej 766,800 leke pa TVSH e ofruar nga ofertuesi ADD GROUP SHPK është një vlerë nën 85% e mesatares se ofertave të vlefshme, e konkretisht me e vogël se zbritja e lejuar e cila del nga prerlllogaritja e formule në vlerën prej 776,377.82 lek pa TVSH. Sa më sipër në zbatim të pikës 5 të nenit 93 të LPP-së, në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, KVO i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarime.*

*Për sa më sipër skualifikimi i ofertës së ankuesit ADD GROUP SHPK është i drejtë dhe duhet të qëndrojë. Në kushtet kur ankuesi është i skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi ai nuk ka më interes të ligjshëm për të kërkuar skualifikimin e ofertuesve të tjerë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi.*

**Së dyti:** *Në lidhje me pretendimet e ankuesit se, oferta e Ervin Luzi P.F, ka pasaktesi në FORMULARIN PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT, sipas shtojcës 9 të DT-së, për informacionin e deklaruar, Sipas Ligji nr 112/2020 Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues, ku në nenin 2/1 Fusha e zbatimit, ka parashikuar që ky ligj nuk zbatohet për:a) Personat fizike, tregtare të regjistruar në regjistrin tregtar; KSHA-ja e autoritetit kontraktor ka vendosur t'i pranohet ato me arsyetimin si më poshtë vijon:*

*PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT Shtojca 9 është një deklaratë vullneti nën përgjegjësi ligjore. Çdo pasaktësi në këtë formular e bën atë të pavlefshëm, Çdo vetedeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për Përrjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik?*

*Vendimarrja e bërë nga KSHA-ja, nuk qëndronë, në kundërshtim me vetë referencat ligjore të bëra në këtë arsyetim nga vetë KSHA-ja dhe për pasojë duhet të shfuqizohen nga Komisioni i Prokurimit Publik. Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës Ekonomike në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar?*

*Në vendimin e KSHA-së nuk është sqaruar se si është plotësuar ky deklaram nga ana e ofertuesit Ervin Luzi PF. Në paragrafin e fundit të vendimit nr. 5040/2 prot., me datë 18.03.2026, KSHA*

ka deklaruar se: Bashkëngjitur këtij komunikimi gjeni dokumentacionin provues që mbështet vlerësimin e kryer dhe shqyrtimin e pretendimeve të ngritura? , por bashkëlidhur këtij vendimi të komunikuar shoqërisë tonë, ky dokumentacion nuk gjendet. Edhe nëse, pretendohet nga ankuesi dhe arsyetohet nga KSHA-ja se, nga ana e ofertuesit Ervin Luzi PF, tek ky deklaram është vendosur ndonjë bazë e të dhënave web, apo ndonjë emer dokumenti, ky fakt nuk mund të përbëjë arsye skualifikimi me argumentin se, meqënëse ofertuesi është person fizik ai nuk duhet të plotësojë asgjë tek ky deklaram, pasi nuk është subjekt i ligjit Nr. 112/2020 Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues. Është absurde të arsyetohet nga KSHA-ja që në këtë rast ndodhemi përpara një deklarimi të rreme sipas dispozitave ligjore të gërmave e) dhe f) të pikës 3 të Nenit 76 (Kriteret detyruese për skualifikim) të Ligjit 162/2020 Për prokurimin publik i ndryshuar

Referimi i bërë nga KSHA-ja në arsyetimin e saj tek pika 3/f) e Nenit 76 (Kriteret detyruese për skualifikim) të Ligjit 162/2020 Për prokurimin publik i ndryshuar, është tërësisht i gabuar pasi, dispozita ligjore e referuar nuk ka asnjë lidhje me situatën e operatorit ekonomik Ervin Luzi PF, pasi kjo dispozitë ligjore lidhet me situatën kur vërtëtohet se, operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin. Deklarimet e bëra në ofertën e tij nga ofertuesi, sipas formatit standart të shtojcës 9 (FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT) të DT-së nuk mund të vlerësohen si ndikime në mënyrë të gabuar në procesin e vendimmarrjes së autoritetit, pasi është në detyrimin e tij të dorëzojë dhe të plotësojë deklaramet sipas kësaj shtojce.

**KËRKOJMË: Shfuqizimin e pjesshëm të vendimit të KSHA-së, nr 5040/2 prot., me datë 18.03.2026, e konkretisht për pjesën në të cilën KSHA-ja ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës Nr aplikimi online: A/2026/6403, të ankesit ADD GROUP SHPK dhe Refuzimin e plotë të ankeses me Nr.protokollit: 761/2026 / Data e protokollit: 2026-03-10, për procedurën e prokurimit Mallra, me Nr. REF-74979-02-02-2026, me objekt Blerje Tonerash për Vitin 2026 . me fond limit 1,666,380 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.**

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik,

III.1. Në lidhje me pretendimet e ankimesit “ADD Group” ShPK, mbi Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Ervin Luzi” P.F. në procedurën e prokurimit sipërcituar me argumente:

**Së pari** Kundërshtojmë klasifikimin e ofertes tonë si “anomalisht të ulët”, për shkak se ky konstatim nga KVO vjen si shkak pasojë i një vlerësimi të pasakatë dhe të padrejtë të ofertave ekonomike të operatoreve të tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi publik, Për dokumentin:

- **Shtojca 9.** (Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

#### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Ka pasaktësi në Formular dhe informacioni e deklaruar Sipas Ligji nr 112/2020 “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues”, ku në nenin 2/1 Fusha e zbatimit, ka parashikuar që ky ligj nuk zbatohet për: a) Personat fizikë, tregtare te regjistruar në regjistrin tregtar;... [...]

III.1.1. Autoriteti kontraktor me Vendimin Nr. 5040/1 Prot. Datë 13.03.2026 e KSHA-së ka vendosur pranimin e pretendimeve të ngritura në ankesë mbi operatorin ekonomik “Ervin Luzi” P.F. e konkretisht në lidhje me Shtojcën 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, i plotësuar

ka pasaktësi dhe i pavlefshëm në plotësimin e deklaramit mbi pronarë përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

[...] Në përmbyllje të shqyrtimit të ankesës, vlerësojmë se pretendimet e ngritura nga ADD Group ShPK janë pjesërisht të bazuara, pasi AK ka vepruar në përputhje me dispozitë të VKM-së 285, Rr. P.P dhe me kërkesat në DST.

*Pretendimi i operatorit ekonomik*

*pranohet pjesërisht vetëm për shtojcën 9 të ankesës dhe rrëzohet për pikën e shtojcën 3 .*

*Konkluzioni:*

*Sa më sipërm referuar ankesës, KSHA vendosi pranimin e pjesshëm të ankesës së operatorit ekonomik “ADD Group” ShPK. [...]*

III.1.2. Njëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6467, datë 31.03.2026 dhe me Nr. 974/2026 Prot., date 31.03.2026 e operatorit ekonomik **“InfoSoft Office” ShPK**, për procedurën e prokurimit *“Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”*, Mallra, me Nr. REF-74979-02-02-2026, me objekt *“Blerje Tonerash për Vitin 2026”*. me fond limit 1,666,380 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nr.5040/2 Prot., datë 18.03.2025.

***Vendimarrja e bërë nga KSHA, nuk qëndron, është në kundërshtim me vetë referencat ligjore të bëra në këtë arsyetim nga vetë KSHA dhe për pasojë duhet të shfuqizohen nga Komisioni i Prokurimit Publik. Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës Ekonomike në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqëruar duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar?***

***Në vendimin e KSHA-së nuk është sqaruar se si është plotësuar ky deklaram nga ana e ofertuesit Ervin Luzi PF. Në paragrafin e fundit të vendimit numër 5040/2 prot., me datë 18.03.2026, KSHA ka deklaruar se: Bashkëngjitur këtij komunikimi gjeni dokumentacionin provues që mbështet vlerësimin e kryer dhe shqyrtimin e pretendimeve të ngritura? , por bashkëlidhur këtij vendimi të komunikuar shoqërisë tonë, ky dokumentacion nuk gjendet. Edhe nëse, pretendohet nga ankesuesi dhe arsyetohet nga KSHA-ja se, nga ana e ofertuesit Ervin Luzi PF, tek ky deklaram është vendosur ndonjë bazë e të dhënave ëeb, apo ndonjë emer dokumenti, ky fakt nuk mund të përbëjë arsye skualifikimi me argumentin se, meqënëse ofertuesi është person fizik ai nuk duhet të plotësojë asgjë tek ky deklaram, pasi nuk është subjekt i Ligjit Nr. 112/2020 PËR REGJISTRIN E PRONARËVE PËRFITUES. Është absurde të arsyetohet nga KSHA-ja që në këtë rast ndodhemi përpara një deklarimi të rreme sipas dispozitave ligjore të gërmave ë) dhe f) të pikës 3 të Nenit 76 (Kriteret detyruese për skualifikim) të Ligjit 162/2020 Për prokurimin publik, i ndryshuar***

*Referimi i bërë nga KSHA në arsyetimin e saj tek pika 3/f) e Nenit 76 (Kriteret detyruese për skualifikim) të Ligjit 162/2020 Për prokurimin publik, i ndryshuar, është tërësisht i gabuar pasi, dispozita ligjore e referuar nuk ka asnjë lidhje me situatën e operatorit ekonomik Ervin Luzi PF, pasi kjo dispozitë ligjore lidhet me situatën kur vërtetohet se, operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin. Deklaramet e bëra në ofertën e tij nga ofertuesi, sipas formatit standart të shtojcës 9 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit) të DT-së nuk mund të vlerësohen si ndikime në mënyrë të gabuar*

në procesin e vendimmarrjes së autoritetit, pasi është në detyrimin e tij të dorëzojë dhe të plotësojë deklaratimet sipas kësaj shtojce.

KËRKOJMË: Shfuqizimin e pjeshëm të vendimit të KSHA-së, numër 5040/2 prot., me datë 18.03.2026, e konkretisht për pjesën në të cilën KSHA-ja ka vendosur pranimin e pjeshëm të ankesës Nr aplikimi të ankesës online: A/2026/6403, të ankuesit ADD GROUP SHPK dhe Refuzimin e plotë të ankeses me Nr aplikimi të ankesës online: A/2026/6403 | Numri i protokollit: 761/2026 Data 2026-03-10, për procedurën e prokurimit Mallra, me Nr. REF-74979-02-02-2026, me objekt Blerje Tonerash për Vitin 2026, me fond limit 1,666,380 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

III.1.3 Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*

*ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

*a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;*

*b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.*

III.1.5. Referuar Vendimmarjes së KSHA-së, mbi pranimin pjesërisht të ankesës së ADD Group ShPK, për pasaktësi në deklaratën e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, shtojca 9, të operatorit ekonomik “Ervin Luzi” P.F, Komisioni do të vijojë shqyrtimin në themel të

pretendimeve të ngritura në ankesën e operatorit ekonomik të interesuar “InfoSoft Office” ShPK, i cili ka paraqitur argumente dhe më pas ka paraqitur ankesë brenda afateve të ankimit, për kundërshtimin e Vendimit të KSHA-së. i cili cënon interesat e tij si operatori i renditur i pari në këtë procedurë.

III.1.6. Autoriteti kontraktor në DST ka publikuar shtojcën 9, **FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT, Në Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit.**

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, kërkohet:**

*Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme \_\_\_\_\_*

III.1.7. Referuar SPE-së, Operatori ekonomik “Ervin Luzi” P.F ka depozituar Dokumentin:



SHTOJCA\_9\_BASHKIA\_VLORE E.Luzi.pdf

Nga shqyrtimi i shtojcës sipërcituar Komisioni konstatoi, se dokumenti është i plotësuar në tërësi në të gjitha pjesët dhe në veçanti Deklarata objekt ankimi, duke dhënë informacionin e kërkuar dhe adresat përkatëse mbi verifikimet e mundshme. Formulari i firmosur dhe vulosur nga operatori ekonomik si vijon:

*Ervin Luzi si Personi/personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:*

*Ervin Luzi  
(plotësuar gjeneralitete)  
Me cilësinë e Administratorit të Ervin Luzi PF.*

*Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.  
Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme PO  
(<https://e-albania.gov.al/>) [Ministria e Financave]*

III.1.8. Në nenin 2 “Qëllimi” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me

qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.  
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.9. Neni 25 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes” i VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP së, janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Këto kritere synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.”

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar në nenin 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.11. Lidhur me pretendimet e ankimesit “InfoSoft Office” ShPK, për kundërshtimin e skualifikimit të Operatorit ekonomik “Ervin Luzi” P.F, për pasaktësi të shtojcës 9, arsyetuar me Vendimin e KSHA-së, Vendim i cili cënon pozitën e tij si rezultat i pranimit të Ankesës së ADD Group ShPK, për mosplotësim të Formularit të Vetëdeklarimit në shtojcën 9, Komisioni mori në shqyrtim Dokumentacionin e Ofertës së operatorit ekonomik “Ervin Luzi” P.F, depozituar në SPE dhe konstatoi, se Shtojca 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, Pjesa II, **Shkaqet e përjashtimit, A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, ku kërkohet:**

*Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.*

Rezulton i plotësuar

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme PO

(<https://e-albania.gov.al/>) [Ministria e Financave] ,

Në analizë të Deklaratës së plotësuar, pjesë e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit konstatohet se operatori ekonomik Ervin Luzi P.F ka plotësuar këtë deklaram duke pohuar dhe jep sqarime në lidhje me adresat referuese mbi verifikimet e deklarimeve të operatorit ekonomik, të cilat nuk konsiderohen deklarim i rremë apo i pasaktë, sikurse Ankimuesi “ADD Group” ShPK pretendon në ankesën e tij dhe pranuar pretendimi nga AK, me Vendimin e KSHA-së, por rezultojnë të dhëna të cilat japin informacionet e nevojshme për AK-në, mbi kryerjen e verifikimeve të të dhënave mbi operatorin ekonomik ofertues në procedurën e prokurimi, i cili rezulton të jetë Administrator i vetëm i Subjektit Ervin Luzi P.F.

Akoma më tej operatori ekonomik Ervin Luzi P.F në Deklaratë nuk ka paraqitur të dhëna mbi emra konkretë apo numra për pronarë përfitues të regjistruar në Regjistrin e Pronarëve Përfitues përkatës, sikurse pretendon ankimuesi “ADD Group” ShPK, për plotësim të pasaktë në përputhje me Nenin 2, pika 2 e Ligjit Nr. 112/2020 “Për Regjistrin e pronarëve përfitues” i ndyshuar se:

*Ky ligj nuk zbatohet për:*

*a) personat fizikë, tregëtarë të regjistruar në regjistrin tregëtar;*

Si konkluzion në analizë të dokumenteve, Komisioni gjykon se pretendimet e “ADD Group” ShPK janë hamendësim mbi parregullsi apo deklarim i pasaktë i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik Ervin Luzi P.F.

Sa më sipër konstatuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik Ervin Luzi P.F. në shtojcën 9, është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi nga ana e tij është plotësuar Formulari me të gjitha të dhënat e kërkuara në tërësinë e tij duke rezultuar i saktë.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPk mbi shfuqizimin pjesërisht të Vendimit të KSHA-së qëndrojnë.

III.2. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “ADD Group” ShPK për operatorin ekonomik “Ervin Luzi” P.F me argumentet:

*Operatori ekonomik Ervin Luzi PF nuk e ka plotësuar Shtojca 3 siç është kërkuar në DST duke parashikuar edhe afatin e lërvimit.*

III.2.1 Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 111, “Paraqitja e ankesës”, pika 2. *Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij.*”. Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij, se: *Operatori ekonomik Ervin Luzi PF nuk e ka plotësuar Shtojca 3 siç është kërkuar në DST duke parashikuar edhe afatin e lërvimit,* ankimuesi duhej të kishte shoqëruar pretendimet

e tij me prova, indicie se ku është bazuar ankimesi si dhe argumente të plota në bazë të të cilave do të shqyrtohen këto pretendime të ankesës.

Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 115 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga autoriteti kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, Komisioni nuk mund të marrë tagrin e operatorit se, mospërmëshja e kriterëve mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë, se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për këto dokumente në mosplotësim të kërkesve autoriteti kontraktor. Në rastin konkret, pesha specifike e barrës për të provuar shkeljen e konstatuar qëndron mbi pretenduesin, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plota provuese, se ku është bazuar ankimesi në ankesën e tij për pasaktësi apo parregulsi në formularin e ofertës të operatorit ekonomik “Ervin Luzi” P.F

Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjitha apo shumicën e elementeve përbërëse të dokumentit objekt ankimi, do të konsiderohet abuziv dhe bazuar në hamendësime të pafaktuara, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë dhe si i tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik, i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve/fakte) dhe provave konkrete.

Rrjedhimisht pretendimi operatorit ekonomik “ADD Group” ShPK nuk merret në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “ADD Group” ShPK në lidhje me pretendimet për skualifikimin e operatorin ekonomik “Ervin Luzi” PF në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” *Mallra*, me Nr. REF-74979-02-02-2026, me objekt “Blerje Tonerash për Vitin 2026”.

me fond limit 1,666,380 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK në lidhje me shfuqizimin pjesërisht të Vendimit të KSHA-së për operatorin ekonomik “Ervin Luzi” P.F në procedurën e prokurimit sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të shfuqizojë pjesërisht Vendimin nr.5040/1Prot., datë13.03.2026 të KSHA-së, mbi skualifikimin për shtojcën 9, operatorin ekonomik “Ervin Luzi” P.F, sipas konstatimeve të mësipërme.
4. Ngarkohet zyra e financës të derdhë në buxhetin e shtetit tarifën financiare të paguar nga operatori ekonomik “ADD Group” ShPK.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, Tiranë.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**

**Anila Malaj**

**Anëtar**

**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**

**Fiorent Zguro**

